



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria Rajonale Lezhë



Lagjia: "Besëlidhja", Tel-Fax. 0215 23 206 www.fsdksh.com.al

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Lezhë shpall vend të lirë pune për:

1 (një) Specialist Farmacist në Sektorin e Rimbursimit pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Lezhë.

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Lezhë janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë;
- Të jetë i pajisur me Liçensën e ushtrimit të profesionit;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësi të punës në grup;
- Të zotërojë kompjuterin;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh;
- Të ketë aftësi menaxhuese;
- Të ketë aftësi për të punuar në grup;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale Lezhë, **brenda datës 22 Shkurt 2017**, si më poshtë:

- Kërkesë për punësim.
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (curriculum vitae).
- Diplomë e noterizuar.
- Diplomë Master e noterizuar.
- Listë notash e noterizuar.

- Certifikatë kompjuteri.
- Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme.
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar.
- Librezën e punës.
- Fotokopje e kartës së indentitetit.
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit).
- Certifikatë Familjare.
- Raport mjekësor për aftësi në punë.
- Liçensën e ushtrimit të profesionit të noterizuar (sipas rastit)

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet.

Adresa:

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

**Lezhë, Lagjja: “Besëlidhja” pranë Maternitetit Lezhë, Tel-Fax. 0215 23 206
www.fsdksh.com.al**